



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2024:347888
Datë: 24.01.2025
Numri i dokumentit: 06753716

C – IV– 24 – 0193

Paditësi - Propozuesi i sigurimit:

Universiteti i Prishtinës me seli në Prishtinë.

Kundër:

Të paditurës – kundërshtarës së sigurimit:

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë, Rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lagjja, “Lakrishtë”, Prishtinë.

Objekti i çështjes : Kërkesa për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit.

Për : Palët ndërgjyqëse

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK) për Çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), Kolegji në përbërje nga gjykatësi, Agron J. Hoxhaj, gjykatës kryesues, Bajram Miftari dhe Diellza Hoxha, gjykatëse - anëtarë të kolegjit, pas seancës vendimmarrëse, të mbajtur me dt.24.01.2025, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

I. Propozimi e paditësit - paditurës – propozuesit të sigurimit, Universiteti i Prishtinës me seli në Prishtinë për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit e me të cilin, ka kërkuar që të lëshoj: “Urdhër për masë ë përkohshme dhe largimin e parcelave nga shitja dhe likudimi sepse përbën dëm të pa riparueshëm për UP dhe Fakultetin”, **REFUZOHET si i pabazuar.**

II. Nuk caktohen taksa tjera gjyqësore në këtë çështje juridike kontestimore.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me dt.06.12.2024, paditësi – propozuesi i sigurimit, Universiteti i Prishtinës me seli në Prishtinë, pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK), ka paraqitur ankesë

kundërr Vendimit të Autoritetit të Likuidimit, PRN208-001 të dt.05.11.2024 e me të cilin, paditësit, i është refuzuar si e pa vlefshme kërkesa e dorëzuar nga B D në mër të Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë - UP për pretendimet pronësore ndaj aseteve të NSh-së, Stacioni i Veterinarisë në Prishtinë dhe se në arsyetimin e këtij Vendimit të AL-së, se kërkesa e tij pranë AL-së, është dorëzuar me dt.12.02.2024 e që ka qenë brenda afatit për parashtrimin e kërkesave .

AL-ja, në arsyetimin e Vendimit të kontestuar të tij, ka shtuar se edhe përkundër provave të bashkangjitura, ka rezultuar se kërkesa e tij nuk ka pasur të bashkangjitura dëshmi të mjaftueshme dhe se për këtë arsye, AL-ja, me shkresën e tij të dt.17.07.2024, ka kërkuar nga paditësi që sjell dëshmitë gjegjëse në mbështetje të kërkesës si tij mirëpo këtë shkresë nuk e ka pranuar dhe se për këtë arsye ka bërë publikimin e kësaj shkrese edhe në televizioet RTK 1 dhe RTK2 si dhe në veb faqen e tij të internetit dhe se paditësi me dt.26.09.2024, por nuk ka arritur që të ofroj ndonjë dëshmi që do të ndikonte në ndryshimin e rrethanave faktike e më gjerësisht si në arsyetimin e Vendimit të kontestuar të AL-së

Paditësit, përmes kësaj ankese, ka bërë edhe propozimin për caktimin e masës së përkohshme e me të cilin, ka kërkuar që gjykata të lëshoj Urdhër për masë ë përkohshme dhe largimin e parcelave nga shitja dhe likuidimi sepse përbën dëm të pa riparueshëm për UP dhe Fakultetin.

Në këtë propozim për caktimin e masës së përkohshme, ka theksuar se ''dëm'', është i pa ri parueshëm'' për shkak se nuk ka asnjë undësi kompensimi në mënyrë të arsyeshme dhe dëmtohet interesi publik madje përmes shitjes së tyre rrezikohet edhe blerësi të mos mund të qasje në këto prova, se po ashtu e informon gjykatën se Klinika veterinare, është pjesë integrale e programeve studimore, ''Mjekësi Veterinare'' dhe ''Prodhimtimi Shtazore'', mbi bazën e të cilit edhe janë akredituar këto dy programe studimore, se studentët kryejnë punë praktike (ushtrimet) në këtë klinikë veterinare , prandaj pa këtë objekt (klinikë) nuk mund të akreditohen këto programe, rrjedhimisht mbyllen.

Po ashtu paditësi – propozuesi i sigurimit, në këtë propozim ka cekur bazën ligjore nga neni 61 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, se kur Dhoma e Posaçme, mund të caktoj një masë të sigurimit e më gjerësisht si në këtë propozim për caktimin e masës së përkohshme të .

Paditësi – propozuesi i sigurimit kësaj ankese dhe propozimi për caktimin e masës së përkohshme, ia ka bashkagjitur provat gjegjëse siç janë :

- Shkresa e dekanit të UP – Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, Nr.01/115 e dt.26.11.2024 të dërguar në adresë të Zyrtarës ligjore të UP-së; lidhur me dokumentacioni për ri shikim të Vendimit të Agjencië Kosovare të Privatizimit, nr.54235/2024 i dt.06.11.2024; Kopja e marrëveshjes Vetëqeverisëse, Kopja e Statutit të Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë; kopja e çertifikatës mbi të drejtat e pronësisë, UL – 71914059 – 09977 e dt.20.05.2011 për ngas.kad.nr.01545 – 0, e evidentuar në emër të Institutiit për Blegtori dhe Veterinari së bashku me kopjen e planit për parcelën kad.nr.1545 -0 në sipërf. prej 4945 m²; kopja e shkresës për formën oganizative të Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, kopja e njoftimit të Komunës së Prishtinës – Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim dt.18.11.2010 për lirimimin e obketeve të Stacionit të Veterinarisë; kopja e kërkesës - përmbajtjees së kërkesës së dt.23.12.2010 e Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë lidhur me lirimimin e objektit të Stacionit të Veterinarisë, kopjen e Vendimit të Këshillit Drejtues të Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, Nr.1/104 të dt.26.07.2011 për miratimin e kërkesës për lirimimin e objektit,

kopja e shkresës, Nr.01 – 120 e dt.25.10.2011 Universitetit të Prishtinës (UP) - Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë për sistematizimin e punonjësve, kopja e kontratës së punës, Nr.3/537 së dt.24.11.2011 e lidhur në mes UP - Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë dhe H P, kopja e akt emërimit, Nr.1/47 e dt.24.4.2012, kopja e kontratës së punës, Nr.3/538 së dt.14.11.2011 e lidhur në mes UP - Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë dhe M A, kopja e Vendimit të UP - Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, Nr.364 i dt.6.2.2013, kopja e kërkesës së UP - Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, Nr.01 – 56 e dt.05.04.2023 të drejtuar Bordit të Drejtorëve të AKP-së, për shfuqizimin e shitjes së "Stacionit të Veterinarisë Prishtinë" KPS 1536U/PRN208 - Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, kopjen e Njoftimit të dt.10, 11, 12, 13, dhe 14.08.2023 i AKP-së, kopja e kërkesës së UP – së, 03/432 e dt.12.09.2023 të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të UHP-së për shfuqizimin e shitjes së "Stacionit të Veterinarisë Prishtinë", KPS1536UU/PRN208 - Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, kopjen e ankesës së bërë nga UP-ja kundër Njoftimit të dt.14.08.2023 të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), Prishtinë, Nr.01 – 56 e dt.05.04.2023 të drejtuar Bordit të Drejtorëve të AKP-së, për shfuqizimin e shitjes së "Stacionit të Veterinarisë Prishtinë" KPS 536U/PRN208 - Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, kopjen e kërkesës, Nr.02/03 të dt.12.2.2024 e Dekanit të Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë për pezullimin e procesit të likuidimit të "Stacionit të Veterinarisë Prishtinë", KPS1536U/ PRN208 – Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë; kopja e Formularit të plotësuar të kërkesës së paditësit e të drejtuar tek AKP-ja, kopjen e kopjen e kërkesës, Nr.02/03 të dt.12.2.2024 e Dekanit të UP - Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, Nr.01 – 56 e dt.05.04.2023 të drejtuar Bordit të Drejtorëve të AKP-së, për shfuqizimin e shitjes së "Stacionit të Veterinarisë Prishtinë" KPS 1536U/PRN208 - Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, kopjen e Njoftimit të dt.10, 11, 12, 13, dhe 14.08.2023 i AKP-së, kopja e kërkesës së UP – së, 03/432 e dt.12.09.2023 të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të UHP-së për shfuqizimin e shitjes së "Stacionit të Veterinarisë Prishtinë", KPS1536UU/PRN208 - Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, kopjen e ankesës së bërë nga UP-ja kundër Njoftimit të dt.14.08.2023 të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), Prishtinë, Nr.01 – 56 e dt.05.04.2023 të drejtuar Bordit të Drejtorëve të AKP-së, për shfuqizimin e shitjes së "Stacionit të Veterinarisë Prishtinë", KPS 536U/PRN208 - Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, kopjen e kërkesës, Nr.02/03 të dt.12.2.2024 e Dekanit të Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë për pezullimin e procesit të likuidimit të "Stacionit të Veterinarisë Prishtinë", KPS1536U/ PRN208 – Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë; kopja e Formularit të plotësuar të kërkesës së paditësit e të drejtuar tek AKP-ja, kopjen e kopjen e kërkesës, Nr.02/03 të dt.12.2.2024 e Dekanit të Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë për pezullimin e procesit të likuidimit të "Stacionit të Veterinarisë Prishtinë" e të drejtuar Bordit të Drejtorëve të AKP-së, kopjen e kërkesës së AKP-së të dt.17.07.2024 për të dhënat shitesë nga paditësi, kopjen e shkresës, Nr.11 – 466/01 -124641/24 të dt.06.09.2024 e Komunës së Prishtinës – Sektori i Kadastrit për – historiatit për ngastrën kadastrale, nr.1538 - 0 ZK, Prishtinë së bashku me kopjen e certifikatës, kopjen e kërkesës, Nr.02/03 të dt.12.2.2024 e Dekanit të Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë për pezullimin e procesit të likuidimit të "Stacionit të Veterinarisë Prishtinë" dhe kopjen e planit për parcelën kad.nr.1545 -0 në sipërf. prej 4945 m², kopjen e Vendimit të AL-së, PRN208 – 001 i dt.05.12.2024, dhe kopjen e kërkesës, Nr.05- 05 e dt.13.11.2024 e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për iniciimin e procedurës së shpronësimit të Institutit të Blegtorisë dhe Veterinarisë, Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë, Universiteti i Prishtinës.

Me dt.12.12.2024, DhPGjSK-ja, me Urdhrin e saj, C - IV. - 24 – 0193 të dt.12.12.2024, ka urdhëruar të paditurën, AKP-në që të paraqes Përgjigje në propozimin e paditësit – propozuesit të sigurimit për caktimin e masës së përkohshme.

Me dt.20.12.2024, e paditura, AKP-ja, ka paraqitur Përgjigje në propozimin e paditësit – propozuesit të sigurimit për caktimin e masës së përkohshme e në të cilën, ka theksuar se asnjëri nga kushtet ligjore për aprovimin e masës së përkohshme sipas nenit 61 të Ligjit, Nr.06/L – 086, nuk është plotësuar, se në bazë të nenit 61 të Ligjit, Nr.06/L – 086:’’ *Pas parashtrimit të propozimit nga njëra palë, Dhoma e Posaçme mund të caktojë një masë të sigurimit me kusht që parashtruesi jep prova të besueshme për ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij dhe se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të riparueshme për palën nëse nuk miratohet masa e sigurimit. Dëmi konsiderohet si i ‘’pariparueshëm’’ vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar’’*, se po ashtu ka cekur mos ekzistencën e të drejtës subjektive.

Po ashtu në këtë Përgjigje, e paditura – kundërshtarja e sigurimit, AKP-ja, lidhur me mos ekzistimin e të drejtës subjektive të paditësit - propozuesit të sigurimit, dhe se kjo është kështu ka shtuar sepse e drejta subjektive nuk nënkupton të drejtën për të pasur pretendime të kundër ligjshme dhe për të cilat dihet se janë të kundërligjshme, se e drejta subjektive, qoftë person fizik apo juridik në një marrëdhënie juridike juridike – civile, e cila rrjedh nga e drejta objektive (e zbatueshme), nënkupton të drejtën subjektive, se e drejta subjektive rrjedh na vet ligji (që janë raste të përcaktuara specifike) apo nga ndonjë punë juridike (kontrata), fillimisht një ndër mënyrat e shuarjes të së drejtës së pronësisë, është kur sendi kalon në pronësi shoqërore, se është me rëndësi të theksohet se në praktikën gjyqësore, mënyra se si ka kaluar prona në pronësi shoqërore, nuk ka qenë me ndikim në vendosjen e rasteve e kjo për shkak se me dispozitat e Ligjit mbi marrëdhëniet Themelore Pronësore, është përcaktuar se me kalimin e pronës në pronësi shoqërore, pronari i mëparshëm e humb pronësinë mbi sendin – pronën, pra në procedurën gjyqësore në momentin e konstatimit të rrethanës se prona kontestuese është shoqërore, po thuajse bëhet e pa nevojshme hetimi i mëtejshëm i historikut të kalimit të pronësisë në pronësi shoqërore.

E paditura – kundërshtarja e sigurimit po ashtu ka theksuar edhe se lidhur me mos ekzistimin e dëmit të pa riparueshëm, në anën e paditësit - propozuesit të sigurimit, ka theksuar se ai para gjykatës, nuk e ka dëshmuar se ai ka një pretendim pronësor të pranueshëm *prima facie* dhe se do të pësonte dëm nëse masa e përkohshme nuk do të miratohej, se pretendimi pronësor i pranueshëm *prima facie* (fumus boni iuris), është një element i domosdoshëm i pranuar si kusht *sine qua non* nga gjykata në praktikën e saj për pranimin e kërkesës për aprovimin e masës së sigurisë e në këtë kuadër, parashtruesi është dashur që të provoj se pretendim i tij pronësor qëndron në masën që ai ka gjasa të dukshme që të fitoj kontestin në gjykatë, se hipotetiki është edhe po të ekzistonte dëmi ai në asnjë rast nuk mund të pranohet si i pa riparueshëm, sepse i pa riparueshëm konsiderohet vetëm kur nuk mund të dëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi monetar, e për të provuar këtë pretendim, duhet të paraqes prova bindëse se dëmi nuk mund të rikuperohet me anë të kompensimit financiar dhe jo mbi bazën e deklarimeve të kërkoj që të vendoset masa e sigurisë.

E paditura – kundërshtarja e sigurimit, në këtë Përgjigje ka referuar edhe në nenin 10 paragrafi 2 të Ligjit për DhPGjSK-së, i cili përcakton se :’’ *Dhoma e Posaçme do të vazhdojë të respektojë*

dhe zbatojë parimin e kompensimit në vend të kthimit fizik. Kur vendoset për mjetin juridik që do të jepet në një rast të caktuar, Dhoma e Posaçme do të marrë parasysh edhe dispozitat në fuqi të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe legjislacionin pasues,

duke përfshirë qëllimet publike që përcaktohen në preambulën e atij ligji.”, se në këtë kuadër. Pretendimi për dëm të menjëhershëm e të pa riparueshëm i parashtruesit, këtu paditësit – propozuesit të sigurimit, është ligjërish i pa paranueshëm, se ka theksuar se pikërisht në mugesë të dëshmirve dhe dokumentacionit relevant për njëhjen e të drejtës së pronësisë, Autoriteti I Likudimit ka refuzuar edhe kërkesën kreditore të parashtruar pranë AL-së përmes Vendmit me nr.PRN208 – 0001, se ka theksuar edhe rregullin bazik të procedurës civile kontestimore sipas të cilit pala kërkueses (aparshtruesi) ka detyrimin dhe barren e provës (neni 7 i Ligjit mbi Procedurën Kontestimore dhe neni 31 i Ligjit, Nr.06/086) e një rregull i tillë është shprehimisht i sanksionuar edhe në nrin 23.2.4 dhe nenin 23.3 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/034, si dhe se ka shtuar se duke u bazuar në atë që u tha më lartë, Agjencia Kosovare e Privatizimit – Autoriteti i Likudimit për NSh, ”Stacionit të Veterinarisë Prishtinë”, në bazë të detyrave të veta ekskluzive sa i përket ruajtjes së aseteve që i ka nën administrim, përmes përgjigjjes ndaj kërkesës së parashtruesit për caktimin e masës së sigurimit, kërkon refuzimin e kërkesës së parashtruesit për caktimin e masës së sigurisë si të pa bazuar e më gjerësisht si në këtë Përgjigje në propozimin e paditësit – propozuesit të sigurimit për lëshimin e masës së sigurimit dhe se kësaj Përgjigjeje ia ka bashkangjitur si prova, kopjen e certifikatës mbi të drejtat e pronësisë, UL – .. e dt.18.12.2024 për ngas.kad.nr..., e evidentuar në emër të Institutit për Blegtori dhe Veterinari së bashku me kopjen e planit për parc. kad.nr.. në sipërf. prej 4945 m².

Me dt.30.12.2024, DhPGjSK-ja, me Urdhrin e saj, C – IV. – 24 – 0913 të dt.27.12.2024, një ekzemplarë të Përgjigjjes së të paditurës – kundërshtarës së sigurimit, ia ka dërguar paditësit – propozuesit të sigurimit dhe se deri më tani nuk ka prova se i njëjti, është përgjigjur në këtë Urdhër.

Arsyetimi ligjor

Ne bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06/L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK) për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Procedura gjyqësore pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në vazhdim: Dhoma e Posaçme), është e rregulluar Ligjin nr.06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si ligj i veçantë.

Përveç kësaj, si ligj procedural i përgjithshëm, zbatohet Ligji për Procedurën Kontestimore (Ligji nr. 03/L-006), me Ndryshimet dhe Plotësimet e këtij ligji dhe se kjo çështje është definuar me Ligjin për Dhomën e Posaçme, neni 76, paragrafi 3, ku është theksuar, se “*Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore*”.

Në bazë të nenit 61 par.2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, gjykata vlerëson se faktet dhe provat që i përmban propozimi për caktimin e masës së sigurimit, nuk e vërtetojnë propozimin për caktimin e masës së sigurimit dhe se gjykata merr aktvendim, pa caktuar seancën dëgjimore. Pas shqyrtimit të propozimit dhe të gjitha parashtrimeve të palëve në procedurë dhe si dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, gjykata ka ardhur në përfundimin se

propozimi i paditësit – propozuesit të sigurimit për caktimin e masës së sigurimit, Universiteti i Prishtinës me seli në Prishtinë, është i pabazuar.

Me nenin 61.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, janë vendosur kushtet ligjore për caktimin e masës së sigurimit, e ku është përcaktuar: *“Pas parashtrimit të propozimit nga njëra palë, Dhoma e Posaçme mund të caktojë një masë të sigurimit me kusht që parashtruesi jep prova të besueshme për ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij dhe se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të riparueshme për palën nëse nuk miratohet masa e sigurimit. Dëmi konsiderohet si i “pariparueshëm” vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar. Propozimi për caktimin e masës së sigurimit duhet dorëzuar së bashku me kërkesën, ose nëse dorëzohet pas parashtrimit të një kërkesë/padie, atëherë ajo duhet t’i referohet asaj kërkesë / padie”*. Siç shihet nga përmbajtja e dispozitës së lartpërmendur, duhet të plotësohen dy kushte ligjore për tu caktuar masa e sigurimit, dhe atë: Provat e lëndës duhet të bëjnë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtës subjektive të paditësit; dhe provat e lëndës duhet të bëjnë të besueshme rrethanën se do të ketë dëm të menjëhershëm dhe të riparueshëm për palën paditëse, nëse nuk miratohet masa e sigurimit.

Provat e besueshme

Paditësi - propozuesi i sigurimit, nuk ka dorëzuar prova për qëllime të vërtetimit të pretendimeve dhe se i njëjti deri në këtë fazë të procedurës nuk ka arritur që të bëjë të besueshme të drejtën subjektive të tij, respektivisht të drejtën pronësore mbi pronën kontestuese derisa nga provat e parashtruar nga e paditura – kundërshtarja e sigurimit përmes përgjigjjes në propozimin e paditësit – propozuesit të sigurimit për caktimin e masës së sigurimit dhe atë kopjes së certifikatës mbi të drejtat e pronësisë, UL..e dt.. për ngas.kad.nr., së bashku me kopjen e planit për parcelën kad.nr.. në sipërf. prej 4945 m², prona në fjalë, evidentohet në emër të Institutit për Blegtori dhe Veterinari e për të cilën ka propozuar caktimin e masës së përkohshme, pra që e paditura – kundërshtarja e sigurimit, AKP-ja, të bëjë largimin e parcelave nga shitja dhe likuidimi sepse përbën dëm të pa riparueshëm për UP dhe Fakultetin, por se kjo pronë, pra, ”Stacioni i Veterinarisë Prishtinë”, është Ndërmarrje Shoqërore (NSh) e me të cilën meanxhon dhe administrin e paditura – kundërshtarja e sigurimit por edhe se për këtë pronë, është bërë kërkesa me Nr.05- 05 e dt.13.11.2024 nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për iniciimin e procedurës së shpronësimit të Institutit të Blegtorisë dhe Veterinarisë, Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë, Universiteti i Prishtinës, andaj në këtë fazë të procedurës, këto rrethana nuk janë provuar nga ana e paditësit- propozuesit të sigurimit, me prova adekuate, e rrjedhimisht paditësi - propozuesi i sigurimit, nuk ka arritur që deri në këtë fazë të procedurës të bëjë kërkesën e tij të besueshme.

Rreziku i shkaktimit të dëmit

Gjykata ka vlerësuar se paditësi nuk ka vërtetuar me asnjë provë as rrethanën se do të ketë dëm të menjëhershëm dhe të riparueshëm për palën paditëse, nëse nuk caktohet masa e përkohshme e sigurimit dhe se paditësi – propozuesi i sigurimit, nuk ka siguruar të dhëna të mjaftueshme se paluajtshmëria kontestuese, do të vendoset në tender publik për qiradhënie apo për privatizim, dhe kjo do të prodhojë dëme për të dhe se dëmet e tilla nuk ka mundësi që të riparohen në të ardhmen, se një dyshim i tillë është i tepërt ngase AKP-ja, e menaxhon Ndërmarrjen Shoqërore (NSh) ”Stacioni i Veterinarisë Prishtinë”, atëherë si mund të plotësohet kriteri bazik i shkaktimit të dëmit kur AKP-ja e për më tepër për këtë pronë, është bërë kërkesa me Nr.05- 05 e

dt.13.11.2024 nga abna Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Prishtinë për iniciimin e procedurës së shpronësimit të Institutit të Blegtorisë dhe Veterinarisë, Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë, Universiteti i Prishtinës. Mirëpo palët duhet të ofrojnë prova të besueshme se do të rezultojnë me dëmtim të menjëhershëm dhe të pa riparueshëm financiarisht nëse nuk miratohet kërkesa e tyre e këto kritere janë përcaktuar në atë mënyrë që nëse ndonjëra nga ato: se ka gjasa reale për t'a fituar rastin, se ai ballafaqohet me shkaktimin e dëmit të pa riparueshëm nëse nuk lëshohet masa e sigurimit etj, dhe nëse njëra nga këto kritere mungojnë, kërkesa do të refuzohet. Barra e provave bie mbi paditësen – propozuesen e sigurimit, andaj pa paragjykim të vendosjes së plotë lidhur me çështjen kryesore të padisë së paditësit – propozuesit të sigurimit, për pretendimin pronësor për pronën në fjalë si dhe për shqyrtimin e ligjshmërisë së Vendimit të AL-së, PRN208 – 001 i dt.05.12.2024, Kolegji i DhPGjSK-së, pra me gjendjen e tillë të shkresave të lëndës, ka gjetur se propozimi i paditësit – propozuesit të sigurimit, Universiteti i Prishtinës me seli në Prishtinë për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, nuk i plotëson kriteret ligjore në frymën e nenit 61 par.1 të Ligjit të Dhomës së Posaçme në vështrim të shkaktimit dëmit të menjëhershëm, andaj edhe propozimin e tillë të paditësit – propozuesit të sigurimit, e refuzoj si të pa bazuar.

Prandaj nga ajo që u tha më lartë, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në bazë të nenit 4 par.9, 9 dhe nenit 61 par.1 të Ligjit Nr.06/L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DhPGJSK).

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS
2024:347888, 24.01.2025

Kolegji i Shkallës së I-rë

Gjykatësi, Agron Hoxhaj, Gjykatës kryesues _____

Gjykatësi, Bajram Miftari, anëtar i kolegjit _____

Gjykatësja, Diellza Hoxha, anëtare e kolegjit _____

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi, pala e pa kënaqur, mund të parashtroj ankesë dhe atë në afatin prej **15 (pesë mbëdhjetë) ditëve** pas ditës së pranimit të këtij aktvendimi e përmes kësaj gjykate e për Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK) e në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK).